



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E VITISË : OPSTINA VITINA	
22-11-2016	
01-013/1500	Vlera Vendnost



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, dhe nenit 36 paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e mbajtur më 22.11.2016, aprovon këtë:

V E N D I M

Për shpalljen në diskutim publik për propozim rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Neni I

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë, MIRATON vendimin për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozim rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve të Komunës së Vitisë.

Neni II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është materiali për propozimin e rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve të Komunës së Vitisë, me numër të protokollit 02-013/1491, i datës 22.11.2016.

Neni III

Propozim rregullorja nga neni 1 i këtij vendimi i lihet në dispozicion për diskutim publik të gjithë qytetarëve të interesuar, organeve dhe institucionet e Komunës së Vitisë, në afat prej 15 dite. Hapja e shqyrtimi publik do të bëhet më datën:12.12.2016 (e Hënë), në sallën e Kuvendit Komunal në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti, duke filluar nga ora 10:00.

Neni IV

Pas përfundimit të kohës për shqyrtim, komentim dhe finalizim të propozim rregullore i dërgohet Kuvendit të Komunës për miratim final.

Neni V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zyra e Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni VI

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. MAPL
3. Shërbimit të Kuvendit
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

